



**URDHËR**

Nr. 73, Datë 24/07/2017

**Mbi marrjen e masave organizative për zbatimin e Udhëzimit nr.15, datë 19.05.2017 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017 - 2018", në Universitetin e Arteve**

Mbështetur në nenin 39, (Rektori), neni 74 (Pranimi në ciklin e parë të studimeve), të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VSA nr. 21, datë 09.05.2017 "Për miratimin paraprak të propozimeve të tarifës së konkurrimit, tarifës së regjistrimit si dhe të tarifës së shkollimit për të gjitha programet e studimit të ofruara nga fakultetet në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2017-2018", VSA nr. 26, datë 13.07.2017, "Mbi përcaktimin e pikëzimit në konkurset e pranimit në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2017-2018", Kreut II, germa B, pikat 1,2,3, e në vijim të "Udhëzimit nr.15, datë 19.05.2017 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017 - 2018", me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes së procedurave të konkurseve të pranimit, evidentimin dhe korigjimin e mangësive që mund të shfaqen,

**URDHËROJ**

1. Ngritjen e grupit të monitorimit të zhvillimit të konkurseve të pranimit, në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2017 - 2018, me përbërje si më poshtë:

- I. Prof. Dr. Erald Bakalli, Zëvendës rektor;
- II. Znj. Sonila Agaj, Përgjegjëse e Sektorit Mësimor & Informimit të Studentëve;
- III. Znj. Edlira Isak Specialiste e Sektorit Mësimor & Informimit të Studentëve

Grupi i monitorimit të marrë masa që: pjesë të "Udhëzimit nr.15, datë 19.05.2017 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017 - 2018", VSA nr. 21, datë 09.05.2017 "Për miratimin paraprak të propozimeve të





tarifës së konkurrimit, tarifës së regjistrimit si dhe të tarifës së shkollimit për të gjitha programet e studimit të ofruara nga fakultetet në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2017-2018", VSA nr. 26, datë 13.07.2017, "Mbi përcaktimin e pikëzimit në konkurset e pranimit në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2017-2018", si dhe listat e dërguara nga QSHA-ja të aplikantëve që konkurrojnë në UA, të afishohen në hyrjet kryesore të fakulteteve dhe në faqen zyrtare të UA, me qëllim informimin sa më mirë të kandidatëve konkurrentë dhe publikut.

2. Pranimet në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, me kohë të plotë në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2017-2018, të bëhen mbi bazën e rezultateve të Maturës Shtetërore dhe rezultateve të fituara në konkursin e pranimit, të organizuara nga Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Artit Skenik dhe Fakulteti i Arteve të Bukura.
3. Kandidatët, të cilët konkurrojnë për një nga programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, me kohë të plotë, në Universitetin e Arteve, rezultatet e konkursit të pranimit llogariten sipas kësaj përqindje:
  - I. rezultatet e Maturës Shtetërore me **30% të totalit të pikëve** (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe gjithë provimet e maturës shtetërore),
  - II. rezultatet e konkurseve të pranimit me **70% të totalit të pikëve**.
  - III. Kandidati që nuk kalon pragun e pikëve minimale të konkursit të pranimit, në programin ku ka konkurruar, nuk fiton të drejtën e studimit.
4. Pikët maksimale që mund të fitojë një kandidat në konkurrim për program studimi **janë 200**, mbështetur në Vendimin e Senatit Akademik nr. 26, datë 13.07.2017.
5. Kandidati, që nuk arrin të fitojë **nën 90 pikët minimale**, të përcaktuara në Vendimin e Senatit Akademik nr. 26, datë 13.07.2017, **nuk fiton të drejtën e studimit**.
6. Konkurset në Universitetin e Arteve do të zhvillohen për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë Bachelor, **nga data 18 gusht deri më 22 gusht 2017**, në ambientet e fakulteteve.
7. Tarifa e regjistrimit e kandidatëve për të konkurruar në një nga programet e studimit në fakultetet e UA është **5 000 (pesë mijë) lekë**, mbështetur në Vendimin e Senatit Akademik nr. 21, datë 09.05.2017, dhe do të arkëtohen nëpërmjet sistemit bankar ose në filialet e postës shqiptare, për llogari të Universitetit të Arteve. Konkurrentët pasi të kenë verifikuar emrin në listat e shpallura në UA, të dërguara nga QSHA-ja, pajisen me mandat arkëtimi nga Drejtoria Ekonomike, pranë Rektoratit të UA, në bazë të cilit bëjnë edhe pagesën në sistemin bankar ose zyrat e postës Shqiptare.
8. FM, FAS dhe FAB në UA, të bëjnë publike në ambientet e çdo Fakulteti si dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve, rregulloret dhe kriteret e konkurseve të pranimit 2017-2018.





9. Periudha e regjistrimit do të nisë nga **ora 08 -<sup>00</sup> e datës 09 gusht 2017** deri në **orën 16 -<sup>00</sup>, të datës 17 gusht 2017.**
10. Regjistrimi i kandidatëve për konkurset e pranimit të bëhen, pranë Sekretarive të Fakulteteve, nga data **09 gusht 2017, ora 08 -<sup>00</sup>** deri në **orën 16 -<sup>00</sup>, të datës 17 gusht 2017.**
11. Sekretaritë mësimore të fakulteteve në UA, pas verifikimit të listave të të regjistruarve, me listat e dërguara nga QSHA-ja, brenda **datës 17 gusht, ora 16-<sup>30</sup>**, të shpallin listat e kandidatëve të regjistruar dhe t'i afishojnë ato në vende të dukshme në mjediset e fakulteteve sipas programeve të studimeve.
12. Regjistrimi i kandidatëve nga sekretaritë e fakulteteve, të bëhet bazuar **në listën e dërguar nga QSHA-ja** me këto dokumente:
  - I. Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë, fotokopje),
  - I. Fotokopje të diplomës së Maturës Shtetërore ose dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave,
  - II. Mandatin e pagesës së tarifës së regjistrimit për konkurrim.
13. Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e MAS, të akorduar për Shqiptarët jashtë kufijve të RSH, për romët dhe egjiptianët, për invalidët paraplegjik dhe tetraplegjik, për jetimët, me statusin e të verbrit, që do të marrin pjesë në konkurset e pranimit, për programet e studimit të ofruara nga Universiteti i Arteve, **aplikojnë** drejtpërdrejt pranë Sekretarive të FM, FAS dhe FAB, në zbatim të "Udhëzimit nr.15, datë 19.05.2017 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017 - 2018", mbështetur në Vendimet e Senatit Akademik, nr. 21, datë 09.05.2017, nr. 26, datë 13.07.2017, nga datat **09 gusht 2017, ora 08 -<sup>00</sup>** deri në **orën 16 -<sup>00</sup>, të datës 17 gusht 2017.**
14. Sekretaritë e FAB, FAS dhe FM, në momentin e regjistrimit të kandidatit për konkurrim në një nga programet e studimit, e pajisin konkurrentin me **"Fletën e Regjistrimit"**.
15. Fleta e Regjistrimit ka këtë përmbajtje:
  - a. Emri dhe mbiemri i kandidatit;
  - b. Programin e studimit në të cilin konkurren;
  - c. Orën, datën, vitin mësimor si dhe ambientin, për t'u paraqitur në konkursin pranues;
  - d. Fleta e Regjistrimit, përgatitet në 2(dy) kopje, dhe firmoset nga K/sekretaria e fakultetit dhe kandidati që konkurren;
- 16 Orari dhe ambientet e zhvillimit të konkurseve të pranimit në fakultete, për çdo program studimi të përcaktohen me urdhër të veçantë të dekanëve të fakulteteve,





brenda datës **08. Gusht 2017**. Urdhri të afishohet në hyrjet kryesore të fakulteteve dhe në faqen zyrtare të UA.

- 17 Dekanët e FM, FAS dhe FAB, janë përgjegjës për zbatimin e "Rregulloreve dhe kritereve të konkursit të pranimit në UA për vitin akademik 2017-2018", të miratuara në Senatin Akademik.
- 18 Sekretaritetë e FM, FAS dhe FAB, pas kryerjes së përlllogaritjeve të pikëve për çdo konkurrent, sipas pikave 3;4;5 të këtij urdhri, si dhe renditjes së konkurrentëve në varësi të pikëve të grumbulluara, afishojnë duke nënvizuar me vijë të kuqe fituesin e fundit, sipas kuotave të përcaktuara për program studimi.
- 19 Brenda datës **28 gusht 2017**, të afishohen dhe publikohen listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID, në mënyrë të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda **28 gusht 2017** të përcillen zyrtarisht një kopje elektronike të këtyre listave SHQA-së. Gjithashtu brenda datës **28 gusht 2017**, të ngarkohet një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-albania.
- 20 Afishimi dhe publikimi duhet bërë me firmën e Dekanit të fakultetit. Listat po në këtë datë përcillen në Rektorat në formë shkresore dhe elektronike në adresën [zvrektor.mes@uart.edu.al](mailto:zvrektor.mes@uart.edu.al).
- 21 Kandidatët kanë të drejtën e ankimit **në datat 29 – 30 gusht 2017** pranë fakulteteve të UA. **Brenda 24 orëve** nga momenti i paraqitjes së ankesave, fakulteti duhet të shprehet me vendim lidhur me ankimet. Vendimet e fakulteteve ankimohen në Gjykatën kompetente.
- 22 Pas përfundimit të afatit të ankimit dhe shqyrtimit të ankesave, përcillen zyrtarisht në QSHA, brenda **datës 01 shtator 2017**, vendimet lidhur me ankimet e aplikantëve si dhe pasqyrohen brenda po kësaj date në portalin U-albania këto vendime në format elektronik. Një kopje e vendimeve përcillet në Rektorat në formë shkresore dhe elektronike në adresën [zvrektor.mes@uart.edu.al](mailto:zvrektor.mes@uart.edu.al).
- 23 Të gjithë kandidatët që janë shpallur fitues, duhet të kryejnë procesin e regjistrimit online dhe me dokumentacion pranë sekretarive të fakulteteve nga data **29 gusht deri më 11 shtator 2017, sipas Kreut II, Raundi I, gërma C, për gjitha pikat e kësaj gërme**. Kandidatët lejohen të regjistrohen vetëm në një program studimi.
- 24 Sekretaritetë e fakulteteve do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë kandidatët fitues personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar nga ana e tyre, si më poshtë:
  - I. Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë. Në dosje mbahet fotokopje),





- II. Fotokopje e noterizuar e diplomës së Maturës Shtetërore ose dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave, ose dëftesë/diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit të njësuar në MAS.
  - III. Deklaratën e paraqitur në shtojcën 3 të udhëzimit nr. 15, datë 19.05.2017, e cila plotësohet në prani të sekretares së fakultetit, dhe nënshkruhet nga kandidati dhe nga sekretarja.
  - IV. Dy fotografi personale
  - V. Mandatin e pagesës së tarifës së regjistrimit për programin e studimit të fituar sipas Vendimit të Senatit Akademik nr. 21, datë 09.05.2017, paguar në sistemin bankar ose në postën Shqiptare.
- 25 Sekretarët e fakulteteve mbajnë regjister të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjister nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të aplikantit pasqyrohet regjistrimi i tij edhe online në portalin U-albania. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretaria firmoset në dy kopje, formulari i printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet aplikantit.
- 26 Brenda **datës 13 shtator 2017**, fakultet e UA të përcjellin në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të parë, bashkë me kuotat e paplotësuar në format elektronik dhe në hardcopy.
- 27 Aplikantët fitues në një program studimi, të cilët nuk janë regjistruar sipas afateve të raundit të parë, humbasin të drejtën për t'u regjistruar. Ata kanë të drejtën që të plotësojnë formularin e aplikimit të raundit të dytë.
- 28 Për të gjitha etapat e konkurseve të pranimit si dhe të regjistrimit të kandidatëve fitues të ndiqen procedurat e parashikuara në përputhje me Udhëzimin nr.15, datë 19.05.2017 *"Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017 - 2018"*.
- 29 Gjithë procedura, e përgatitjes dhe e fazës së konkurrimeve, për pranimet në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, në UA, monitorohen nga përfaqësues të autorizuar të MAS si dhe grupit të monitorimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri.
- 30 Sektori i Shërbimit pranë Rektoratit të UA, në bashkëpunim me shoqërinë SH.R.S.F. "ISA" shpk, me objekt shërbimin e ruajtjes me roje civile, të UA për vitin 2017, gjatë periudhës së regjistrimit dhe zhvillimit të konkurseve të pranimit, për student në fakultetet e UA, të marrë këto masa:
- a. shërbimi i ruajtjes me roje civile të angazhohet maksimalisht, për zbatimin e rregullave në mjediset e UA dhe të jetë në gatishmëri në raste konflikti;
  - b. të ushtrohen kontrole për personat që futen në ambientet e fakulteteve dhe të Rektoratit;





- c. gjatë periudhës, **datë 18/08/2017 deri datë 22/08/2017**, zona e parkimit, brenda territorit të UA, të jetë e lirë. Në këtë ambient, mund të parkohen vetëm automjetet sipas një liste të miratuara nga Administratori i UA.
- 31 Ditët e konkurseve, **hyrja e konkurrentëve**, do të bëhet vetëm nga hyrja kryesore e Universitetit të Arteve (sheshi Nënë Tereza), të cilët **do të shoqërohen nga punonjës të caktuar nga Dekanët e fakulteteve**, për t'u drejtuar në ambientet e fakulteteve ku edhe do të zhvillohen konkurset e pranimit.
- 32 Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen: Zëvendës rektori, Dekanët e FM, FAS, FAB, Administratori i UA, Sekretarët e fakulteteve, Drejtorja Ekonomike pranë Rektoratit, Sektori i Shërbimeve pranë Rektoratit, Personeli akademik dhe administrativ me detyra specifike në regjistrimin dhe zhvillimin e konkurseve të pranimit të studentëve të ciklit të parë në UA, për vitin akademik 2017 - 2018.
- 33 Ngarkohet sektori i IT, që këtë Urdhër t'a publikojë në faqen zyrtare të internetit të Universitetit të Arteve, në rubrikën studentët si dhe në rubrikën njoftime.
- 34 Ky urdhër, zyrtarisht t'ju dërgohet: Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe shoqërisë SH.R.S.F. "ISA" shpk.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

Prof. Kastriot ÇAUSHI



REKTOR  
UNIVERSITETI I ARTEVE

